

VADEMECUM AMBIENTIM ME PJESEMARRJE

Të dashur prindër,

hyrja në çerdhe është një moment shumë i rëndësishëm për fëmijët tuaj dhe për të gjithë familjen. Është një eksperiencë e re: ndarja e parë, takimet e para me fëmijë dhe të rritur të tjerë në një ambient ndryshe nga ai i familjes. Pikërisht për këtë arsye kjo eksperiencë e re ka nevojë për kohë, përkujdesje dhe delikatesë.

Për ne është themelore që ambientimi/familjarizimi të vijë në mënyrë **graduale**, duke marrë në konsideratë nevojat e fëmijës dhe tuajat si prindër. Një fëmijë përjeton me më shumë qetësi hyrjen në çerdhe, kur ndjen qetësi dhe besim nga ana e kujt e shoqëron. Të njohësh ambientin, edukatorët, rutinën e përditëshme dhe projektin edukativ ndihmon në krijimin e besimit.


Familja dhe ekipi i edukatorëve ndajnë një objektiv të përbashkët: **mirëqënien e fëmijës**. Për këtë arsye mendojmë që raportet dhe bashkpunimi reciprok janë elementët basë, veçanërisht përgjatë momentit delikat të ndarjes.

Duke u nisur nga këto reflektime, çerdhet bashkiake kanë zgjedhur një mënyrë të re ambientimi, të quajtur **ambientim me pjesëmarrje (ose tre ditor)**. Për tre ditë radhazi, ju dhe fëmija juaj do të jetoni bashkë përditshmërinë e çerdhes, duke marrë pjesë në momente të ndryshme gjatë ditës: mirëseardhja, loja, ndërrimi, dreka, dhe për më të vegjëlit, gjumi.

Kjo kohë e përbashkët i jep mundësi fëmijës të njohi më mirë ambientin e ri duke pasur pranë një figurë afektive referimi, duke e bërë të ndjehet i mirëpritur dhe i mbështetur. Në të njëjtën kohë, ju jep mundësinë juve si prindër të njihni nga afër jetën në çerdhe dhe planin e edukimit duke ju bërë të ndjeheni pjesë aktive të këtij rrugëtimi.

Në faqet pas ardhëse do të gjeni disa këshilla praktike për tju orientuar në përditshmërinë e shërbimit dhe disa reflektime mbi mënyrën tonë të të jetuarit kontekstin edukativ. Të ndarit e kohës, regullave dhe kuptimit të gjërave është për ne pjesë përbërëse e një **rrugëtimi bashkëpërgjegjësie**, ku familja dhe ekipi i çerdhes ecin bashkë, në respektin e roleve reciproke.

Pedagoget



UDHËZIME ORGANIZATIVE PËRGJATE AMBIENTIMIT/FAMILJARIZIMIT

- **Orari i frekuentimit:** gjatë tre ditëve të ambjentimit qëndrimi në çerdhe zgjat përafërsisht nga ora 9:00 deri në orën 13:00 (nga ora 8:00 për grupin e parë të fëmijëve – grupi 1);
- **Dita e katërt:** prindi shoqëron fëmijën dhe qëndron brënda në çerdhe për aq kohë sa është e nevojshme që ai të jetë i qetë. Momenti i përshëndetjes dhe largimit do të vendoset bashkë me ekipin e edukimit. Ribashkimi parashikohet rreth orës 13:00;
- **Disponueshmëria e prindërve:** duke nisur nga dita e katërt është e rëndësishme që prindi të jetë i disponueshëm, në mënyrë të atillë që të ndërhyjë në qoftë se është e nevojshme, në respektin e mirëqënies së fëmijës;
- **Veshja:** këshillohet një veshje e rehatshme si për fëmijën edhe për prindin, për të favorizuar lëvizjet, lojën dhe eksplorimin;
- **Gjumi:** fëmijët e grupit të parë mund të përjetojnë eksperiencën e gjumit përgjatë paradites duke filluar nga ditët e para të ambjentimit/familjarizimit. Për fëmijët e grupit të dytë dhe të tretë, kjo eksperiencë do të jetë e mundur në një moment tjetër, duke u ndarë me familjen dhe duke respektuar kohën e nevojshme të cdo fëmije;
- **Figura e referencës:** është parashikuar prezenca e vetëm një të rrituri pranë. Personi referues mund të ndryshojë gjatë ditëve për sa kohë i garantohet fëmijës ndjenja e vazhdimësisë dhe qëndrueshmërisë.

SI TË QËNDROSH NË ÇERDHE PËR TRE DITË? SI TË BASHKERENDONI QËNDRIMET EDUKATIVE

- **Të qënurit i pranishëm:** Është e rëndësishme të jesh i pranishëm në mënyrë autentike, duke shmangur çpërqëndrime nga përdorimi i telefonit;
- **Të tregohesh i kujdesshëm:** Të të qënurit i kujdesshëm duke u treguar mikpritës dhe i disponueshëm ndihmon fëmijën të ndjehet i sigurt për të eksploruar me më shumë qetësi ambjentin e ri perqark;
- **Ndiqui iniciativën e fëmijës:** Jepini mundësi fëmijës që të jetë në krye të lojës dhe zbulimit të gjërave të reja, duke e shoqëruar, pa e udhëzuar dhe parashikuar lëvizjet e tij. Mbështetja përgjatë autonomisë forcon besimin dhe aftësinë tek vetja.
- **Respekto udhëzimet e ekipit edukues:** Ndarja e rregullave,metodat e qëndrueshmërisë dhe marrëdhënies ndihmojnë në krijimin e një ambjenti të qetë, koherent dhe të respektueshëm për të gjithë;
- **Mbështet pa u zëvendësuar:** Tregohu fisikisht dhe emocionalisht i disponueshëm, duke i lënë fëmijës hapësirën e nevojshme për tu bërë i zoti vetes;
- **Mikprit emocionet:** Dalloni emocionet e fëmijës (dhe tuajat), pa i minimizuar apo parashikuar ato. Ti japësh një emër emozioneve ndihmon fëmijët ti kuptojnë më mirë;
- **Jepi kohën e nevojshme:** Cdo fëmijë ka nevojë për kohën e vet. Është e rëndësishme të mos bëni presion në marrëdhënie me të tjerët, gjatë përditshmërisë, ngrënies, ndarjes apo gjumit;
- **Bëj kujdes në momentin e ndarjes:** Përshëndetja duhet të jetë në mënyrë të qartë dhe koherente duke rënë dakort me ekipin edukues. Mos u largoni fshehurazi, pa ja thënë fëmijës:parashikueshmëria forcon sigurinë emocionale.